



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DIBËR**  
**DREJTORIA E PALANIFIKIMIT KONTROLLIT DHE ZHVILLIMIT TERITORIT**

**PROJEKT - VENDIM**

Nr. \_\_\_\_ Datë 26/02/2021

**“Për miratim Stacionesh Urbani”**

Bazuar ne ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe bazuar ne vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr 159 datë 28/11/2020, per miratimin e Terminalit te Automjeteve per Transportin e Pasagjerëve , i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin , 27/1 prot. datë 08/01/2021, për tu ardhur në ndihmë qytetarëve për levizjen e tyre, në mes Terminalit tek ish- Parku dhe lagjeve të qytetit, të vendosën automjete transporti urban për qytetarët.

Bazuar në këtë fakt,

**KËRKOJMË:**

**“Miratimin e Stacioneve për autobuzat urban, që do të vihen në dispozicion të qytetarëve për levizjen e tyre nga lagjet e qytetit deri tek Terminali Ish – Parku, si me poshtë:**

- Stacioni nr 1 Terminali tek ish - Parku.
- Stacioni nr 2 tek Ish -Agjensia e vjetër, tek sheshi në pazar
- Stacioni nr 3 tek pallati i ri ne afersi te Prefektures.
- Stacioni nr 4 tek kryqezimi ish- shkolles Bujqësore në afersi të karburantit.
- Stacioni nr 5 tek kryqezimi i Komisariatit
- Stacioni nr 6 tek karburani “Shulke” dhe kthim

- Stacioni nr 1 Terminali ish - Parku.
- Stacioni nr 2 Karburanti ne Lagjen “ Vehbi Dibra”
- Stacioni nr 3 Kryqezimi rruges kryesore me rrugen e Lagjes Vraniçe, perballe objektit të qytetarit Agim Hoxha.
- Stacioni nr 4 tek Xhamia e vjetër
- Stacioni nr 5 tek ish - Çentrali elektrik
- Stacioni nr 6 tek qendra Balneare Llixha dhe kthim.

Orari i levizjes se urbaneve do te jete nga ora 06 e tridhjete minuta deri ora 22 e tridhjete minuta.

Bileta që do paguhet nga ana e qytetarëve, për transportin urban në linjat e mësipërme do të jetë 30 lek.

Bashkëngjitur keni hartën e lagjeve të qytetit si dhe vendqëndimet e autobuzit urban.

Me zbatimin e këtijë urdhëri ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Mbështetese , Drejtoria e Urbanistikës dhe Sektori i Taksave.

Ky vendim hynë në fuqi pas miratimit nga ana e Keshillit Bashkiak Dibër, dhe shprehjes për bazushmeri ligjore nga institucioni i Prefektit Qarkut Dibër.

Drejtori i Shërbimeve Mbështetese    Drejtori i Urbanistikës    Përgjegjësi i Sektorit Taksave


Shkelqim MURRJA




Bedri SHEHU



Bujar MANJA



KRYETARI I BASHKISE



Dionis IMARAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM Nr 16 Datë 03.03.2021

**“Për miratim Stacionesh Urbani”**

Bazuar ne ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe bazuar ne vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr 125 datë.02.10.2020, per miratimin e Terminalit te Automjeteve per Transportin e Pasagjereve , i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër Nr. 1543/1 prot. d, meqenese nga subjekti perkates, qe ka ne pronesi Terminalin, ne bashkepunim edhe me Bashkine Diber, eshte rene dakort per tu ardhur ne ndihme qytetareve per levizjen e tyre, te vendos dy automjete transporti per qytetaret, qe do te levizin nga lagjet deri tek terminali, Këshilli Bashkiak Dibër I mbledhur sipas urdherit 633 datë 17.11.2020 me datë **03.03.2021** miratoi me 17 vota pro 1 kundër 1 apstenim me datë **03.03.2021**

VENDOSI:

**“Miratimin e Stacioneve për autobuzat urban, qe do te vihen ne dispozicion te qytetareve qe do levizin nga lagjet e qytetit deri tek Terminali si me poshte:**

Stacioni nr 1 Terminali tek ish - Parku.  
Stacioni nr 2 tek Ish -Agjensia e vjeter, tek sheshi ne pazar  
Stacioni nr 3 tek pallati i ri ne afersi te Prefektures.  
Stacioni nr 4 tek kryqezimi ish- shkolles Bujqesore ne afersi ie karburantit  
Stacioni nr 5 tek kryqezimi i Komisariatit  
Stacioni nr 6 tek karburani “Shulke” dhe kthim

Stacioni nr 1 Terminali ish - Parku.  
Stacioni nr 2 Karburanti ne Lagjen “ Vehbi Dibra”  
Stacioni nr 3 Kryqezimi rruges kryesore me rrugen e Lagjes Vraniçe, perballe objektit te qytetarit Agim Hoxha.  
Stacioni nr 4 tek Xhamia e vjeter  
Stacioni nr 5 tek ish - Çentrali elektrik  
Stacioni nr 6 tek qendra Balneare Llixha dhe kthim.

Orari i levizjes se urbaneve do te jete nga ora 06 e tridhjete minuta deri ora 22 e tridhjete minuta.

Adresa: Bulevardi “ELEZ ISUFF”, Peshkopi, [email:bashkiadiber@gmail.com](mailto:bashkiadiber@gmail.com) nr.tel:00355218229

Bileta qe do paguhet nga ana e qytetareve, per transportin urban ne linjat e mesiperme do te jete 30 lek.


Bashkengjitur keni harten e lagjeve te qytetit si dhe vendqendimet e autobuzit urban.

Me zbatimin e ketije urdheri ngarkohet Drejtori i Sherbimeve Mbeshtetese , Sektori i Urbanistikes dhe Sektori i Taksave.

Ky vendim hyne ne fuqi pas shprehjes per bazushmeri Ligjore nga institucioni i Prefektit Qarkut Diber.

Kryetar Këshilli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.275/1.prot.

Peshkopi, më 16.03.2021

Lënda : Per vendimin nr. 16, datë 03.03.2021 të Këshillit të Bashkisë Dibër

Drejtuar : BASHKISE DIBER

PESHKOPI

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër nr.16, date 03.03.2021 "Për miratim Stacioni Urbani", miratojmë në parim vendimin objekt verifikimi dhe shqyrtimi që bën pjesë në fushën e kompetencave të veta të njësive të vetëqeverisjes vendore, nën përgjegjësinë direkte administrative-ligjore të strukturave të posaçme të Bashkisë Dibër të specifikuar në dispozitivin e vendimit nr.16, datë 03.03.2021.

